




AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep: 2-D/ Nr. I treg: 03 Nr. pagues:	Nr. Prot: 01-253/16 Prot No: Data: 21-01-2016 Datum:



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	21.01.2015
REFERENC-Ë:	AKK-DPK-03-02/24/16
PËR/ZA/TO:	z. Have Krasniqi , Udhëheqëse e Divizionit të Burimeve Njerëzore – AMMK
CC:	Ilir Morina, Kryeshef Ekzekutiv i AMMK - së
PËRMES/PREKO/THROUGH:	
NGA/OD/FROM:	Hasan Preteni, <i>Preteni</i> Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me ofrimin e këshillimit profesional për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

E nderuara znj. Krasniqi,

Në mbështetje të nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.12) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 (paragrafi 1 pika 1.6) të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me kërkesën tuaj, për shqyrtimin e gjendjes së mundshme të konfliktit të interesit, në rastin kur zyrtari i lartë z. Afrim Berisha – U.d Drejtor për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor lidhur me pjesëmarrjen e tij në komisionin për zhvillim të procedurës së rekrutimit, në të cilën ai me njërin prej kandidatëve të këtij konkursi ka lidhje familjare. Në pajtim me mandatin që kemi dhe duke u bazuar në Ligjet bazë të Agjencisë, Agjencia kundër Korrupsionit ofron këtë:

O P I N I O N

Ekziston konflikt rast për rast i interesit për zyrtarin e lartë z. Afrim Berisha lidhur me pjesëmarrjen e tij në komisionin për zhvillim të procedurës së rekrutimit, në të cilën ai me njërin prej kandidatëve të këtij konkursi ka lidhje familjare.

Kjo për më tepër edhe nga fakti se z. Afrim Berisha, ka bërë deklaram paraprak të konfliktit të interesit.

A R S Y E T I M

Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit nr.04/L-051 (në tekstin e mëtejme Ligji për PKI), ka përcaktuar kategorinë e zyrtarëve të lartë publik të cilët e kanë obligim zbatimin e këtij Ligji. Në këtë rast Anëtari i Komisionit z. Afrim Berisha në funksionin publik U.d Drejtor për Monitorim, Vlerësim dhe Raportim Mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor hynë në mesin e kategorisë së zyrtarëve të lartë publik dhe i nënshtrohen dispozitave të këtij Ligji (neni 4).

Ky Ligj në nenin 7 (paragrafi 1,3,5,8) ka përcaktuar parimet e veprimit dhe mosveprimit të zyrtarit të lartë të cilat janë:

1. *“Zyrtari i lartë gjatë ushtrimit të funksionit publik duhet të veproj në mbrojtje të interesit publik dhe nuk ka të drejt që interesin e tij privat ta vërë para interesit publik, për mbrojtjen e të cilit është zgjedhur apo emëruar”.*
3. *“Zyrtari i lartë duhet ta kryej punën e tij me ndershmëri, ndërgjegje, paanshmëri, të ruajë autoritetin e zyrtarit të lartë dhe institucionit dhe me punën e tij të rrisë besimin e qytetarëve në institucione”.*
5. *“Zyrtari i lartë nuk ka të drejt të shfrytëzojë funksionin publik për përfitim të kundërligjshëm për vete apo për të tjerët”.*
8. *“Zyrtari i lartë nuk duhet të lejoj që interesat e tij private të bien në konflikt me funksionin e tij. Ai duhet të shmang konfliktin e interesit pavarësisht nëse ai është real, apo i mundshëm”.*

Po ashtu në nenin 6 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit është paraparë nocioni i konfliktit të interesit i cili përcakton se *“konflikti i interesit është gjendja e mospajtimit ndërmjet detyrës publike dhe interesave private të zyrtarit të lartë, kur ai ka interesa private të drejtpërdrejta ose të tërthorta, personale ose pasurore, të cilat ndikojnë, mund të ndikojnë ose duket sikur ndikojnë në ligjshmërinë, transparencën, objektivitetin dhe paanësinë e tij gjatë ushtrimit të funksionit publik”.*



Lidhur me pyetjen tuaj për situatë të mundshme të konfliktit të interesit, ju njoftojmë se në këtë rast ekziston konflikt rast për rast i interesit lidhur me vendimmarrjen e zyrtarit të lartë publik neni 13 (paragrafi 1,2,3), të Ligjit nr. 04/L-051, në të cilën shprehimisht thuhet:

1. *“Çdo zyrtar i lartë gjatë ushtrimit të funksionit të tij publike, në bazë të njohurive të tij dhe në mirëbesim, detyrohet që të bëjë vet deklarimin paraprak, rast për rast, të ekzistencës së interesit të tij private lidhur me vendimmarrjen në një çështje të caktuar, që mund të bëhen shkak për lindjen e një konflikti të interesit”.*
2. *“Deklarimi rast për rast i interesave private bëhet çdo herë nga zyrtari i lartë, kur kjo kërkohet nga eprori ose nga institucioni mbikëqyrës. Deklarimi si rregull duhet kërkuar dhe bërë paraprakisht. Kur kjo nuk është e mundur ose kur nuk ka ndodhur, deklarimi duhet të kërkohet të bëhet sa me shpejt që të jetë e mundur”.*
3. *“Vetë deklarimi si rregull bëhet me shkrim, kur zyrtari i lartë përfshihet në një vendimarrje për ndonjë çështje të caktuar”.*

Zyrtari i lartë z. Afrim Berisha, përkundër deklarimit paraprak të konfliktit të interesit, ka vazhduar të jetë pjesë e komisionit vlerësues.

Përkufizimi Interes privat sipas Ligjit për PKI, neni 3 (paragrafi 1.2), konsiderohet:

- 1.2. *“Interesi privat pasuror ose personal jo pasuror i zyrtarit të lartë që mund të ndikojnë në vullnetin e tij në vendimarrje gjatë ushtrimit të funksionit publik”.*

Përveç Ligjit PKI, konfliktin e interesit e ka paraparë edhe Rregullorja për Kodin e Mirësjelljes për Shërbimin Civil (Nr.04/2015). Në nenin 14 (paragrafi 3) të kësaj Rregulloreje parashihet se:

3. *“Nëpunësi civil gjatë kryerjes së detyrës kur ka dijeni për ekzistimin e konfliktit të interesit është i detyruar që:*
 - 3.1 *”Të identifikoj nëse ka një konflikt të mundshëm të interesit”.*
 - 3.2 *”Të ndërmarrë hapat e nevojshëm për të shmangur vet konfliktin e interesit”.*

Andaj, bazuar në atë që u tha më lart kërkojmë nga ju të ndërmerrni veprimet e nevojshme për parandalimin dhe zgjidhjen e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik sipas dispozitave ligjore të lart cituara.

Me respekt!